

VENDIM
Nr. 181, datë 12.9.2024

**MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË “MAGNA SOLAR POWER” SHPK NË
VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 16, 37, pika 2, germa “a” dhe 38, pika 1, germa “a” të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; neneve 4, pika 1, germa “a”, 5, pika 1, germa “a”, dhe 13 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar; si dhe neneve 15 dhe 19, pika 1, germa “a” të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 12.9.2024, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1756/9 prot., datë 9.9.2024, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes “Mbi kërkesën e shoqërisë ‘Magna Solar Power’ sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike”,

konstatoi se:

- Shoqëria “Magna Solar Power” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1756 prot., datë 12.8.2024, ka paraqitur kërkesën për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltai, me kapacitet të instaluar 2 mw, në fshatin Sheq Marinas, Njësia Administrative Topojë, Bashkia Fier, qarku Fier.

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 169, datë 26.8.2024, vendosi të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë në këtë veprimtari.

- ERE botoi njoftimin në median e shkruar për fillimin e kësaj procedure (në datat 27.8.2024 dhe 28.8.2024) dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve apo të objeksioneve nga të tretët (data 6.09.2024), nuk rezultoi të ketë të tilla. Njoftimi për fillimin e procedurës u botua edhe në faqen zyrtare të internetit të ERE-s. Gjithashtu, me shkresën nr. 1756/5 prot., datë 30.8.2024, ERE ka njoftuar Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) për fillimin e kësaj procedure.

- Me shkresën nr. 1756/2 prot., datë 26.8.2024, shoqëria ka depozituar dokumentacion plotësues të aplikimit, nga shqyrtimi i të cilit ka rezultuar se ka ende dokumentacion që nevojitet të plotësohet, ndaj ERE iu drejtua shoqërisë me shkresën nr. 1756/4 prot., datë 30.8.2024.

- Pas korrespondencës së zhvilluar në vijim me shoqërinë, rezulton se me shkresat nr. 1756/6 prot., datë 3.9.2024 dhe nr. 1756/8 prot., datë 6.9.2024, ajo ka plotësuar dokumentacionin e munguar.

- Nga analizimi i aplikimit, në referencë të përcaktimeve të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, rezulton se shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit sipas përcaktimeve të aneksit A dhe ka plotësuar dokumentacionin e kërkuar në zbatim të nenit 9 për pikën 1.1, gjerat “a” “b” dhe “c”; për pikën 1.2, gjerat “a”, “b”, “c”, dhe “d”; pikën 1.3, gjerat “a”, “b”, dhe “c”; për pikën 2.1, gjerat “a”, “b”, “c”, “d”, “e” dhe “f”.

- Rezulton se shoqëria “Magna Power Solar” sh.p.k.:

- Ka nënshkruar me MIE-n kontratën me nr. 10939 rep., nr. 4910 kol., datë 1.8.2022;

- Ka nënshkruar me shoqërinë “Operatori i Sistemit të Shpërndarjes” (OSSH) sh.a. marrëveshjen e lidhjes së re, nr. 8316/2 prot., datë 30.7.2024, për lidhjen e centralit fotovoltai me rrjetin e shpërndarjes;

- Është pajisur me vendim për VNM-në paraprake, lëshuar më datë 9.5.2022, nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM), për të ndërtuar impiantin fotovoltai me fuqi 2 mw dhe ka dokumentuar në ERE fillimin e punimeve brenda afatit të VNM-së, si dhe ka bërë me dije se centrali është gati për fillimin e operimit të energjisë elektrike.

- Shoqëria ka njoftuar MIE-n me anë të shkresës datë 18.3.2024 duke vë në dijeni se në datën 16.3.2024 ka filluar punimet për ndërtimin e centralit fotovoltaik; më datë 24.4.2024 i është drejtuar MIE-s, duke e vënë në dijeni se në zbatim të nenit 9 të kontratës është në pritje të zbardhjes së lejes së ndërtimit nga Këshilli Kombëtar i Territorit; si dhe me anë të shkresës së datës 8.8.2024, drejtuar Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore, në zbatim të përcaktimeve të nenit 10 të kontratës së nënshkruar me MIE-n, ka bërë njoftimin për testimin e veprës, e cila sipas përcaktimeve të këtij neni duhet të fillojë brenda 45 ditë pas marrjes së njoftimit. Për gjithë sa më sipër, rezulton se MIE ka dijeni në lidhje me vonesat në marrjen e lejeve të nevojshme për ndërtimin e centralit dhe nuk rezulton që të jetë depozituar në vijim ndonjë qëndrim i saj.

- Gjithsesi, në çdo rast, ERE rezervon të drejtën e rishikimit të vendimit të saj në qoftë se depozitohet një dokument i ndryshëm nga dokumentacioni që ka shërbyer për marrjen e këtij vendimi.

- ERE, në zbatim të nenit 38, pika 1, germa “a” të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, dhe nenit 5, pika 1, germa “a”, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, lëshon një licencë për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike deri në 30 vjet, referuar dhe garancisë së produktit të depozituar në ERE nga shoqëria, e cila është 30 vjet, vlerësohet se vlefshmëria e kësaj licence të jetë 30 vjet, duke filluar nga hyrja në fuqi e këtij vendimi.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë “Magna Solar Power” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik me kapacitet të instaluar 2 mw, në fshatin Sheq Marinas, Njësia Administrative Topojë, Bashkia Fier, qarku Fier, për një afat 30-vjeçar

2. Shoqëria duhet të fillojë ushtrimin e aktivitetit të prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik, brenda afateve të përcaktuara në kontratën me MIE-n.

3. Ky vendim është objekt rishikimi në rast se depozitohet/konstatohet një dokumentacion i ndryshëm nga ai që ka shërbyer për këtë vendimmarrje.

4. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, të njoftojë shoqërinë “Magna Solar Power” sh.p.k., Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, shoqërinë “Furnizuesi i Tregut të Lirë” sh.a. dhe shoqërinë “Operatori i Sistemit të Shpërndarjes” sh.a. për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit, në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti